



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241532
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05566798

AC-I-23-0288

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

I N, nga fshati D, Komuna e Deçanit.

kundër

E paditura

NSH "Gjeravica", (në likuidim), Deçan, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. 'Dritan Hoxha' nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Diellza Hoxha gjyqtar, duke vendosur sipas ankesës së paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-4484 të datës 18 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Ankesa e paditësit e datës 16 maj 2023, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4484 të datës 18 prill 2023, konsiderohet e tërhequr.**

2. **Asnjëra palë nuk ka të drejtë në rimbursimin e shpenzimeve procedurale.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 10 qershor 2014, paditësi e ka dorëzuar një ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ146-0046 të datës 06 maj 2014, me të cilën është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim të tri pagave të pa paguara për periudhën 01.07.1990 e deri 30.09.1990, në shumë prej 1,710.00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit si të pabazuara në ligj. Paditësi pohon se nuk ka pasur njohuri që kontestet e tilla për tri paga duhet të paraqiten brenda tri viteve në gjykatën kompetente. Tutje paditësi pohon se ka të drejtë në të tri paga të cilat janë mbetur borxh për periudhën e cekur.

Me datë 03 shkurt 2023, AKP-ja e ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP-ja pretendon se ankesa është e pa pranueshme pasi që objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa paditësi ka dështuar të tregojë se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar. Tutje AKP-ja në këtë parashtrësë konsideron se kërkesa për tri pagat e kërkuara ndaj NSH-së është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 18 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-4484 e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se duke u bazuar në nenin 42 par.2 të LDHP-së dhe nenin 7 të LPK-së, barra e provës bie mbi paditësin, ai nuk ka dorëzuar dëshmi relevante për të vërtetuar se NSH-ja i ka mbetur borxh për tri pagat e kërkuara, e as ndonjë specifikacion lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara, nuk ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të

Likuidimit, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe as prova tjera për ti mbështetur pretendimet ankimore. Tutje Shkalla e I-rë konstatoi se është lëshuar një urdhër për paditësin me datë 20 dhjetor 2022, dhe ju dha mundësia që të sjellë prova shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore, por i njëjti ka sjellë aktvendime të ndryshme nga marrëdhënia e punës të viteve 1984, 1990, 1989,1997 dhe 1999, të cila nuk janë relevante lidhur me tri pagat e kërkuara ndaj NSH-së.

Me datë 17 maj 2023, paditësi përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-4484 të datës 18 prill 2023, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesa paditësi pohon se Autoriteti i Likuidimit është thirrur në Ligjin e Punës së Bashkuar të vitit 1976, i cili është ligj i vjetër që tani nuk ekziston andaj ky ligj është i relevant. Tutje në ankesë ai pohon se ka sjellë aktvendime nga marrëdhënia e punës, kontratën e punës dhe njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 29.02.2012, dhe pohon se ka prova për të vërtetuar të drejtën e tij në këto tri paga. Nga këto arsye ai ka kërkuar që të aprovohet ankesa dhe të detyrohet AKP-ja ti paguajë tri pagat e pa paguara në shumë prej 1,710.00 euro. Bashkë me ankesë ka dorëzuar njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe aktvendime nga marrëdhënia e punës të viteve të ndryshme të dorëzuara edhe më herët në këtë Gjykatë.

Me datë 31 maj 2023, Zyrtarja për financa e DHPGJS-së ka nxjerr Vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë në shumën prej 20 Eurove, brenda 15 ditësh. Me anë të këtij njoftimi, ankuesi është paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën brenda afatit ligjorë prej 15 ditësh, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), nenit 6.4, 6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikim të tarifave të gjykatës, do të konsiderohet e tërhequr. Ankuesi po ashtu është njoftuar se mund të parashtron kërkesën për lirim nga taksat gjyqësore në rast të mungesës së mjeteve financiare.

Vërejtja është dorëzuar tek paditësi me datë 06 qershor 2023. Ankuesi deri më sot nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ka parashtruar kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Sipas nenit 253.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK): "Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar".

Më tutje, neni 253.5 thotë që: "Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, dhe nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr".

Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 (UA) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), përcaktimi i taksës gjyqësore për t'u paguar në kohën kur është paraqitur/parashtruar parashtresa, është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e parashtresës.

Neni 2.4 i UA-së e përcakton se shprehja "Parashtresë", do të thotë padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për ekzekutim.

Udhëzimi i KGJK-së nr. 01/2017 i aplikueshëm që nga data 15/03/2017 për unifikimin e Taksave Gjyqësore të DHPGJS-së përcakton se ankuesi duhet të paguaj shumën fikse prej 20 euro për parashtrimin e ankesës.

Pasi që ankuesi nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar nga ai me njoftimin (vërejtja) e datës 31 maj 2023, që ishte pranuar nga paditësi me datë 06

qershor 2023., dhe nuk ka paraqitur kërkesë për lirim nga taksat gjyqësore, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa është tërhequr.

Sipas nenit 11 të Ligjit për DHPGJS-në, pala e pasuksesshme duhet t'i paguaj shpenzimet procedurale, përfshirë taksat gjyqësore të palës tjetër. Ankuesi në këtë çështje është palë e pasuksesshme, prandaj shpenzimet gjyqësore janë në barrë e saj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendosë si në dispozitiv.

Vendosur nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, më 12 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues, _____